

1 E mërkurë, 5 prill 2023

2 [Deklarata hyrëse]

3 [Seancë e hapur]

4 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

5 --- Seanca fillon në orën 09.00

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

7 Mirëmëngjesi, të gjithëve.

8 Znj. Sekretare e Gjykatës, ju lutem thërrisni çështjen.

9 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
10 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i
11 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
12 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

14 Vërej se z. Thaçi, z. Veseli, z. Selimi dhe z. Krasniqi
15 janë të pranishëm gjithë në sallën e gjyqit.

16 Sot do të dëgjojmë deklaratën hapëse të z. Krasniqi.
17 Kujtoj që udhëzimet e dhëna të hënën vazhdojnë të jenë të
18 zbatueshme edhe sot.

19 Znj. Alagendra, fjala është për ju. Keni një orë e gjysëm
20 në dispozicion.

21 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
22 Gjykatës.

23 Mirëmëngjes, z. Kryegjykatës, anëtarë të Trupit Gjykses
24 dhe kolegë të tenderuar. Shumë çështje janë ngritur nga
25 kolegët e mi të nderuar Mbrojtja e z. Thaçi, e z. Veseli dhe e

1 z. Selimi. Në prezantimin tim sot do të përpiqem që të jem
2 koncize dhe të mos përsëris parashtrimet e bëra nga kolegët e
3 mi.

4 Për çështje planifikimi, parashikoj se do të më duhen jo
5 më shumë se 45 minuta për fjalën time hyrëse. Dhe, me lejen
6 tuaj, të nderuar Gjykatës do të kërkoj që t'i jepni fjalën dhe
7 z. Krasniqi. Dhe ju kërkoj ju që atij t'i jepet 25 minuta për
8 t'ju drejtuar Gjykatës. Dhe, nëse do të më lejoni, do të më
9 duhen edhe 5 minuta të tjera për të përfunduar fjalën time.

10 Jakup Krasniqi tani është 72 vjeç. 25 vjet më parë, ai u
11 ndje i detyruar të kyçej në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës për
12 të mbrojtur popullin e vetë në lidhje me një sulm të dënuar
13 nga bota e lirë dhe, sipas parashtrimeve të mia, të dënuar jo
14 vetëm nga bota e lirë por edhe nga të gjithë njerëzit me dhe
15 besime me qëndrime normale. Nuk mund të harrojmë faktin se
16 regjimi kundër të cilit ai po luftonte ishte i njëjti regjim
17 që shkaktoi kaos dhe oqean lotësh, zemërthyerje, mjerime dhe
18 shkatërrime në shkallë të gjerë në të gjithë Ballkanin.

19 Ky regjim shkaktoi, mes krimesh të tjera edhe gjenocidin
20 në Srebrenicë. Ndoshta mund ta kuptoni arsyen pse Jakup
21 Krasniqi atëherë 47-vjetçar ju desh të linte mënjanë shpresat
22 dhe ëndrrat e tij për një jetë paqësore për të luftuar për
23 popullin e Kosovës dhe për fëmijët e tij si dhe për brezat e
24 ardhshëm që do të jetonin në një Kosovë paqësore.

25 Roli i Jakup Krasniqit si zëdhënësi i UÇK-së është i

1 njohur publikisht për 25 vjet, një çerek shekulli. Që nga
2 shpallja e emërimit të tij në qershor 1998, deklaratat e bëra
3 prej tij në mbështetje të UÇK-ë u bënë publike. Në
4 marrëdhëniet e tij me mediat dhe përfaqësuesit ndërkombëtarë,
5 ai përdorte emrin e tij. Ai nuk ka përdorur pseudonime.
6 Gjithçka që ka bërë ka qenë publike dhe e hapur.

7 18 vjet më parë z. Krasniqi u intervistua dhe më pas u
8 thirr si dëshmitar nga Zyra e Prokurorit të TPNJ-së, nga një
9 ekip që përfshinte ndër të tjerë edhe ushtruesin e detyrës së
10 Prokurorit të Specializuar z. Alex Whiting. Ai dëshmoi në
11 çështjen Limaj në vitin 2005 dhe çështjen Haradinaj në vitin
12 2007. Askush nuk sugjeroi se ai ishte i dyshuar apo se ishte
13 personalisht i lidhur me ndonjë krim. Pas dëshmisë së tij, ai
14 u kthye në Kosovë.

15 Z. Krasniqi ka dhënë dëshmi si dëshmitar në dy çështje të
16 tjera në vitin 2018. Përsëri, nuk ka pasur sugjerime se ai
17 ishte i dyshuar apo fajtor për ndonjë krim apo shkelje në atë
18 çështje edhe pse krimet themelore në atë çështje janë pjesë e
19 bazës kriminale në këtë çështje gjyqësore.

20 Është e rëndësishme të theksohet gjithashtu se z.
21 Krasniqi nuk përmendej në raportin e Këshillit të Evropës të
22 vitit 2011 si i dyshuar për ndonjë përgjegjësi penale. Pas më
23 shumë se 20 vitesh hetime të krimeve të luftës të kryera nga
24 TPNJ-ja dhe po aq vite shqyrtimi intensiv politik dhe mediatik
25 në Kosovë, z. Krasniqi nuk është arrestuar kurrë për një krim.

1 Megjithatë, më 4 nëntor 2020, rreth orës 06.00 të mëngjesit,
2 shtëpia e tij u rrethua nga policë të armatosur, shtëpia u
3 kontrollua në praninë e familjes së tij dhe ai u soll në Hagë
4 i prangosur.

5 Në moshën 70 vjeçare, pavarësisht historisë së tij të
6 bashkëpunimit me drejtësinë ndërkombëtare, atij nuk ju dha
7 asnjë mundësi dinjitoze për t'u paraqitur vullnetarisht.

8 Të nderuar Gjykatës, ne parashtrojmë se ai meritonte më
9 shumë.

10 Me të vërtetë ishte një goditje e madhe për z. Krasniqi
11 dhe familjen e tij dhe, të nderuar Gjykatës, edhe për të
12 gjithë popullin e Kosovës. Njerëzit u tronditën dhe u hutuan
13 sepse nuk i lidhnin dot akuzat në këtë aktakuzë me personin që
14 ata e kanë njohur që është z. Krasniqi dhe personin që ai
15 është sot.

16 Kam besim të plotë se gjatë gjithë këtij gjykimi ju, të
17 nderuar Gjykatës, do të shihni jo vetëm sesi Prokuroria ka
18 dështuar në mënyrë të dukshme në përpjekjen e saj për të
19 provuar çështjen kundër z. Krasniqi përtej dyshimit të
20 arsyeshëm, por do të shikoni gjithashtu edhe sesi ai nuk duhet
21 të ishte akuzuar fare.

22 Të nderuar Gjykatës, hapja ime do të përqendrohet në
23 gjashtë gabimet thelbësore që ne parashtrojmë që janë fatale
24 për çështjen e Prokurorisë. Këto gjashtë pika janë vetëm disa
25 prej shembujve të shumtë të gabimeve të tjera që ka bërë

1 Prokuroria dhe që ju të nderuar Gjykatës do t'i shikoni gjatë
2 këtij gjykimi.

3 Gabimi i parë, të nderuar Gjykatës, është që Prokuroria
4 e keqkupton ose qëllimisht e keqpërfaqëson rolin personal të
5 z. Krasniqi.

6 Në qershor të vitit 1998, z. Krasniqi u emërua si
7 zëdhënës. Ai nuk kishte asnjë rol të përcaktuar para asaj
8 kohe. Ashtu siç nuk ishte as edhe një shtab i përgjithshëm në
9 kuptimin e plotë të fjalës.

10 Megjithatë, nga qershori i vitit 1998, z. Krasniqi ishte
11 zëdhënës. Të nderuar Gjykatës, ne të gjithë e dimë shumë mirë
12 çfarë roli ka zëdhënësi dhe kufizimet e tij. Zëdhënësit nuk
13 përfshihen në çështje operationale ushtarake. Roli i tyre
14 është kontakti dhe marrëdhëniet me publikun. Ky, të nderuar
15 Gjykatës, ishte pikërisht roli që ka luajtur z. Krasniqi në
16 atë kohë.

17 Këtu, me respekt dëshiroj që t'ju sjell diçka në
18 vëmendje. Të nderuar Gjykatës, ju do të dëgjoni dëshmitarë të
19 flasin për strukturën e UÇK-së, disa prej të cilëve nuk kanë
20 asnjë bazë për njohuritë e tyre të supozuara përtej
21 thashethemeve apo spekulimeve të painformuara. Do të dëgjoni
22 dhe dëshmitarë të Prokurorisë që flasin për z. Krasniqi edhe
23 pse ata dinë vetëm emrin e tij sepse e kanë parë në televizion
24 apo në media apo vite pas përfundimit të konfliktit. Ne jemi
25 të bindur se ju, të nderuar Gjykatës, do t'i analizoni provat

1 dhe do të hidhni poshtë ato prova që nuk kanë bazë në
2 njohuritë aktuale ose që bazohen në hamendësime.

3 Më pas do të them disa fjalë lidhur me komunikatat.

4 Nuk mund të nxirret si përfundim, nga pozita e tij si
5 zëdhënës, se z. Krasniqi ishte përgjegjës personalisht për të
6 gjitha komunikatat mbi të cilat Prokuroria vendos kaq shumë
7 peshë. Pozicioni i Prokurorisë është se komunikata e parë
8 është nxjerrë në vitin 1994, dhe kjo është shumë kohë më
9 përpara se z. Krasniqi të bëhej zëdhënës. Ato vazhduan gjatë
10 gjithë luftës dhe është e qartë që nuk kanë dalë nga një burim
11 i vetëm. Disa, për shembull, nxirreshin nga zonat operative.

12 Dy ditë më parë, Prokuroria parashtroi, vazhdimisht, se
13 gjatë kërkimit në shtëpinë e z. Krasniqi janë gjetur dokumente
14 të caktuara. Nëse këto dokumente janë gjetur në këtë mënyrë
15 dhe keqpërdorimi i kërkimit është tashmë përpara jush, të
16 nderuar Gjykatës, kjo nuk vërteton automatikisht përtej
17 dyshimit të arsyeshëm se z. Krasniqi është autor i këtyre
18 dokumenteve ose ai i zotëronte këto dokumente në kohën
19 materiale. Thjesht gjetja e këtyre dokumenteve në shtëpinë e
20 tij nuk i bën ato autentike. Kjo është një pikë e qartë dhe
21 themelore, por në një farë mënyre duket se është e kuptuar keq
22 nga Prokuroria.

23 Në fund të fundit, të nderuar Gjykatës, z. Krasniqi është
24 shkrimtar dhe historian, është personi i cili mbledh materiale
25 për hulumtimet e veta, për interesat e veta dhe për librat e

1 tij të shumtë. Ai ka mbledhur, i janë dhënë apo ka një
2 koleksion të shumë dokumenteve ndër vite. I takon Prokurorisë
3 barra të provojë se kur janë shkruar këto dokumente, kur i ka
4 marrë ai në zotërim, kush i ka hartuar ato dhe për çfarë
5 qëllimi.

6 Në mesin e nëntorit 1998, si pjesë e një përpjekje më të
7 gjerë për t'u organizuar, z. Krasniqi u emërua si njëri nga dy
8 zëvendëskomandantët. Prokuroria nuk e pranon se ka pasur
9 dallim në mes të roleve të dy zëvendëskomandantëve. Një
10 zëvendëskomandant ishte përgjegjës për operacionet, ndërsa
11 zëvendëskomandanti i dytë ishte përgjegjës për mbështetje,
12 funksion ky i kryer nga z. Krasniqi. Pyetja që ju, të nderuar
13 Gjykatës duhet t'i bëni vetes është që pse Prokuroria është
14 kaq vendosur për të mos përmendur një hollësi të tillë as në
15 aktakuzë dhe as në dosjen paragjyqësore.

16 Vetëm dy ditë më përpara Prokuroria prezantoi
17 diapozitivin B44, me titullin "Organigrama e Shtabit të
18 Përgjithshëm në vjeshtë të vitit 1998". Ku thuhej qartë
19 "zëvendëskomandant për mbështetjen", megjithatë vetëm fjalët
20 zëvendëskomandant u lexuan me zë prej Prokurorisë.

21 Sapo pranohet se roli i z. Krasniqi ka qenë i kufizuar në
22 mbështetje, një rol administrativ ky dhe se ka pasur një
23 tjetër zëvendëskomandant dhe një shef të shtabit që merrej me
24 çështje operative, atëherë pretendimi se z. Krasniqi ishte
25 komandant me kontroll efektiv mbi luftëtarët bie tërësisht

1 poshtë. Prokuroria gjithashtu nuk pranon se vetëm tre muaj më
2 vonë ka pasur një ndryshim të dukshëm në përbërjen e Shtabit
3 të Përgjithshëm në shkurt të vitit 1999. Për këtë do të flasim
4 disa nga dëshmitarët e parë të zgjedhur nga Prokuroria. E
5 vërteta e thjeshtë është se pas shkurtit të vitit 1999, nuk ka
6 asnjë dëshmi se z. Krasniqi ishte zëvendëskomandant.

7 Gjatë rrjedhës së këtij gjykimit, të nderuar Gjykatës, ju
8 do të dëgjoni dëshminë për rolin e z. Krasniqi nga shumë
9 dëshmitarë, përfshirë dhe persona brenda përbrenda UÇK-së që e
10 njihnin atë si zëdhënës gjatë periudhës përkatëse, një rol që
11 ai e ka kryer nga prilli 1999 për Qeverinë e Përkohshme të
12 Kosovës, jo për Shtabin e Përgjithshëm. Në verën e vitit 1999,
13 ai u emërua si Ministër i Ndërtimit dhe Zhvillimit në këtë
14 qeveri, një rol në të cilin u emërua jo nga UÇK-ja, jo nga
15 Qeveria e Përkohshme e Kosovës, po nga një parti tërësisht
16 tjetër që është: Lëvizja e Bashkuar Demokratike, e njohur
17 ndryshe si LBD.

18 Provat e Prokurorisë do të tregojnë rolin e vërtetë të z.
19 Krasniqi. Ai nuk kishte kompetenca apo përgjegjësi që kërkon
20 t'i ngarkojë ZPS-ja, as aktivitetet e tij publike si zëdhënës
21 nuk mund të lidhen me asnjë krim që pretendohet prej
22 Prokurorisë.

23 Në fund, gjatë gjithë periudhës 18 mujore të aktakuzës
24 dhe në më shumë se 40 vende, aktakuza, në fakt, vetëm
25 pretendon se z. Krasniqi personalisht ka marrë pjesë në krime

1 në tri raste. Në të tria rastet, gjithçka që duhet të themi
2 tani është se provat do të tregojnë që ZPS-ja ka gabuar.

3 Të nderuar Gjykatës, gabimi i dytë i Prokurorisë është
4 insistimi i saj se Jakup Krasniqi ishte përgjegjës për krimet
5 nga të cilat ishte gjeografikisht i largët.

6 Shembuj të qartë të këtyre janë periudha nga 6 deri në 25
7 shkurt 1999, ku z. Krasniqi ka qenë jashtë Kosovës duke marrë
8 pjesë në negociatat e Rambouillet.

9 Nga 10 marsi deri më 19 mars 1999, ai u kthye në Paris
10 për fazën e dytë të negociatave.

11 Nga 19 marsi 1999, z. Krasniqi nuk ishte në gjendje që të
12 ktheheshe në Kosovë dhe deri më 15 qershor 1999, për të gjithë
13 periudhën tre mujore, ai ka qëndruar në Shqipëri, pavarësisht
14 periudhës së shkurtër në të cilën ai bëri një tur në vendet e
15 Evropës Perëndimore.

16 Sipas Gjykatës së Apelit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale
17 në çështjen Bemba, distanca fizike e z. Krasniqi ka rëndësi të
18 madhe. Ai nuk ka qenë në një marrëdhënie hierarkike me autorët
19 fizikë të krimeve. Ai nuk kishte aftësi për të kontrolluar në
20 mënyrë efektive ndonjë luftëtar, për të mos folur këtu fare
21 për ata që ishin larg gjeografikisht dhe që nuk ishin fare të
22 lidhur me punën e tij të përditshme si zëdhënës.

23 Një simptomë tjetër e natyrës të papërqendruar të kësaj
24 çështjeje që Prokuroria nuk e shpjegon është mënyra sesi
25 propozon që të provojë që ai kishte aftësinë ose pushtetin që

1 të parandalonte ose që të ndëshkonte një sërë krimesh që
2 pretendohen që të jenë kryer në një vend, në një shtet tjetër.

3 Pika e tretë ose gabimi i tretë i Prokurorisë, të nderuar
4 Gjykatës, është që ajo mbivlerëson tërësisht organizimin e
5 UÇK-së.

6 Prokuroria parashtroi një teori të pabazuar se UÇK-ja
7 ishte më e organizuar sesa ajo ishte në fakt e organizuar.
8 Provat do të tregojnë që kjo teori ishte thjesht një fantazi,
9 një teori e cila injoron realitetin në terren. Të nderuar
10 Gjykatës, ju dëgjuat deklaratat e Mbrojtjet së z. Thaçi, z.
11 Veseli dhe z. Selimi. Nuk do të përsëris parashtimet, por
12 mjafton që të them që them që Prokuroria duket sikur është
13 bërë pjesë e propagandës kundër UÇK-së, duke interpretuar
14 dokumente ndryshe siç ka qenë situata në terren ndërkohë
15 provat do të tregojnë të kundërtën.

16 Provat do të tregojnë se organizimi UÇK-së ishte i
17 ndryshëm në vende të ndryshme, si dhe ishte i ndryshëm me
18 kalimin e kohës, por asnjëherë nuk ka arritur standardet e një
19 strukture formale ushtarake.

20 Përpara sesa të përcaktoj fazat e ndryshme në zhvillimin
21 e UÇK-së, një zhvillim që tregon faza të ndryshme të
22 dezorganizimit të UÇK-së në të cilat ajo po mendohej që të
23 bëhej një ushtri e rregullt e organizuar, megjithatë kjo mbeti
24 në nivel të aspiratave që nuk u arrit asnjëherë, ndërkohë kjo
25 ishte si rezultat i sulmeve të shumta të forcave serbe, më

1 lejoni, që të nxjerr në pah një tjetër mungesë të madhe të

2 Prokurorisë: Ku është ekspertiza ushtarake e Prokurorisë?

3 Në një çështje të tillë, pra, për strukturat komandës

4 është e rëndësishme, që të merret parasysh ky element?

5 Ndërkohë, ajo çfarë ajo çfarë keni përpara jush, të nderuar

6 Gjykatës, janë qindra e mijëra dokumente, ndërkohë që, të

7 nderuar Gjykatës, juve ju kërkohet që copa të ndryshme të

8 mozaikut t'i bashkoni vetë.

9 Në fillim të periudhës së aktakuzës, të nderuar Gjykatës

10 e dëgjuam dhe dje këtë gjë këtë gjë, që UÇK-ja ishte vërtetë

11 një grup vullnetarësh që u organizuan në fshatra në mënyrë që

12 të mbroheshin, të mbronin veten dhe familjet e tyre. Nuk

13 kishte asnjë lidhje në pjesën e sipërme të hierarkisë apo të

14 Shtabit të Përgjithshëm. Ndërkohë lojaliteti personal dhe

15 familjar i mbledhi pjesëtarët e UÇK-së më shumë sesa një

16 sistem apo rregulla të kodifikuara. Ata zgjodhën liderët dhe

17 udhëheqësit e tyre dhe këta udhëheqës ishin përgjegjës për

18 luftëtarët dhe nuk kishin përgjegjësi sipër.

19 Këto grupe u bashkuan në momentin kur u konfrontuan me

20 shkelje të rënda të të drejtave njerëzore nga forcat serbe.

21 Përpijekjet e këtyre vullnetarëve drejtoheshin kundër armikut

22 ushtarak dhe jo kundër popullsisë civile.

23 Deklaratat publike të aso kohe duhet të konsiderohen,

24 duhet të shqyrtohen në këtë kontekst si përpjekje për të

25 rritur mbështetjen për përpjekjet e luftës kundër forcave

1 serbe dhe për të dhënë shpresë dhe moral për njerëzit.

2 Dua të ndaloj për një moment në faktin që këta luftëtarë
3 ishin vullnetarë. Pjesa më e madhe e tyre nuk kishin fare
4 përvojë ushtarake apo trajnim ushtarak. Ata vinin nga të
5 gjitha fushat e jetës ishin: studentë, fermerë, mësues,
6 doktorë, juristë. Vinin nga të gjitha partitë politike. Ata
7 nuk paguheshin. Ata u bënë luftëtarë për të mbrojtur fëmijët,
8 gratë, burrat e Kosovës. Ata nuk mund të qëndronin pa bërë
9 asgjë dhe të bënin sikur asgjë s'po ndodhte.

10 Është e vështirë që të vlerësohet shkalla e mungesës së
11 organizimit këtu në Hagë sa i takon njohurive që të gjithë
12 kemi ne sa i takon funksioneve ushtarake. Ne flasim rreth
13 njerëzve që bënin roje pa armë. Flasim për vullnetarë të cilët
14 duhet që të shkonin në Shqipëri për të gjetur, për të marrë
15 armët dhe uniformat e tyre. Po flasim për persona të cilët
16 duhet që të kalonin rrugë, të cilat kontrolloheshin nga forcat
17 serbe, udhëtime të cilat ishin të vështira, të rrezikshme dhe
18 që merrnin orë të tëra, kështu që për këtë arsye ata duhej që
19 të përdornin rrugë në terrene të vështira edhe më të gjata.

20 Të nderuar Gjykatës, provat do të dëgjojnë që UÇK-ja nuk
21 ka qenë kurrë në gjendje që të arrijë nivelin e organizimit që
22 pretendohet nga Prokuroria.

23 Të nderuar Gjykatës, ju keni dëgjuar përpjekjet për
24 organizim të cilat u fshinë nga ofensiva e verës. Vullnetarët
25 i lanë armët, u larguan nga shtëpitë e tyre dhe në shumë raste

1 u larguan dhe nga Kosova. Shumë njësite të tjera u zhdukën ose
2 u çorganizuan.

3 Një tjetër përpjekje sa i takon organizimit filloi në
4 hapësirën e ofruar nga marrëveshja e armëpushimit ndërmjet
5 Holbrooke dhe Milosheviçit dhe përfshiu përpjekjen në nëntor
6 të vitit 1998 për të krijuar ato çfarë u quajtën drejtori.
7 Është e rëndësishme të theksohet se duhet kohë që të krijohen
8 institucionet dhe organizata të reja kur punon me vullnetarë,
9 me persona pa përvojë, në mes të një konflikti të armatosur,
10 me burime të kufizuara. Kur janë bërë përpjekje për t'u
11 organizuar pritshmëria ishte që lufta do të zgjaste për vite
12 të tëra. Ata nuk e dinin që lufta do të përfundonte brenda
13 gjashtë muajsh.

14 Drejtoritë që jepen në letër, që shkruhen në letër, në
15 nëntor të vitit 1998 nuk duhet që të merren si drejtori
16 plotësisht funksionale dhe të organizuara të llojit që janë të
17 njohura dhe që të jenë të zakonshme për ushtri të rregullta.
18 Ata thjesht ishin një bërthamë që përbëheshin ose nga një
19 person ose një numër shumë i vogël personash dhe nuk kishin as
20 administratë apo udhëzime përpara t'i mbështetur ata.

21 E njëjta gjë mund të thuhet edhe për vetë Shtabin e
22 Përgjithshëm, që nuk ka qenë asnjëherë organi që funksiononte
23 mirë, qeverisës, që e përshkruan Prokuroria. Shumë dëshmitarë
24 brenda UÇK-së do të dëshmojnë që ata as nuk e dinin fare se
25 cilët ishin pjesëtarët e Shtabit të Përgjithshëm apo rolet e

1 tyre.

2 Rregulloret e përmendura nga Prokuroria nuk duhet të
3 merren siç duket. Ato mund të duken në pamje të parë si
4 rregullore, por logjikisht, ato nuk mund të zbatoheshin duke
5 pasur parasysh rrethanat e UÇK-së edhe po të ishte kështu nuk
6 mund të jenë ekuivalent të ushtrive të rregullta. Për
7 shembull, paragrafët e parë të rregulloreve disiplinore mbi të
8 cilat mbështetet Prokuroria për të vërtetuar aftësinë për të
9 ndëshkuar i referohen kushtetutës. UÇK-ja nuk kishte një
10 kushtetutë. Këto rregullore reflektonin vetëm thjesht aspirata
11 dhe jo pozicionin e vërtetë.

12 Për më tepër, të nderuar Gjykatës do të dëgjoni nga shumë
13 dëshmitarë të UÇK-së që nuk kishin fare njohuri për
14 rregulloret e shkruara apo përmbajtjet e tyre.

15 Në pranverë 1999, përpjekjet për t'u organizuar sërish u
16 cenuan rëndë në një valë tjetër të ofensivave serbe. UÇK-ja
17 edhe një herë u shpërnda, u çua në vende të tjera dhe po
18 mbijetonte në kushte edhe më të vështira sesa më parë. Pas
19 qershorit të 1999, pas bombardimit të NATO-s dhe tërheqjes
20 serbe, si luftëtarët e UÇK-së dhe qindra e mijëra civilë u
21 kthyen në Kosovë. U kthyen për të gjetur anëtarë të familjes
22 të vdekur, shtëpitë e djegura, ndërkohë që pronat e tyre apo
23 kafshët e familjeve ishin shkatërruar. Individë në këto
24 rrethana mbase mund të kenë përfituar nga rasti për të marrë
25 hakmarrje. Ndërkohë që situata ishte e tëra kaotike. Dhe,

1 ndërkohë, vullnetarët po largoheshin nga UÇK-ja, duke u kthyer
2 në kthyer në shtëpi për të kërkuar të afërmit e tyre. Ndërkohë
3 KFOR-i po ashtu nuk kishte kapacitet për policim apo për
4 parandalimin e krimeve.

5 Provat do të tregojnë që nuk ka pasur asnjëherë një
6 zinxhir funksional vertikal komande. Dëshmitarët e Prokurorisë
7 njëri pas tjetrit do të vijnë dhe do i tregojnë kësaj Gjykate
8 rreth kufizimeve të komunikimit, mungesës së raportimit dhe
9 mungesës së tyre të informimit sa i takon rregulloreve të UÇK-
10 së mbi të cilat mbështetet Prokuroria. Nga fillimi dhe deri në
11 fund Shtabi i Përgjithshëm nuk ka pasur asnjëherë aftësinë që
12 të imponojë një plan të përbashkët për luftëtarët duke e
13 quajtur veten Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

14 Së katërti, Prokuroria nuk ka marrë parasysh
15 jurisprudencën e TPNJ-së.

16 Konstatimet e lidhura me këtë çështje, në fakt, ne do
17 thoshim, janë vendimtare për shumë çështje, të cilat janë
18 trajtuar dhe nga kolegët e mi të nderuar më përpara, për
19 shembull, nga çështjet Limaj dhe Haradinaj. Një pjesë e mirë e
20 provave të prezantuara përpara jush, të nderuar anëtarë të
21 Trupit Gjykues janë prova që janë mbledhur nga TPNJ-ja dhe që
22 janë përdorur në këtë çështje. Megjithatë, pavarësisht kësaj
23 gjëje, kjo Prokuroria është e vendosur që t'ju ftojë ju, të
24 nderuar Gjykatës, që të arrini përfundime që janë të ndryshme
25 dhe ndonjëherë që janë tërësisht të kundërta me konstatimet

1 dhe vendimet e marra nga nëntë gjyqtarë të Trupit Gjykues në
2 çështjet Limaj dhe Haradinaj.

3 Kjo përpjekje do të dështojë. Në qoftë se nuk ka njohuri
4 të mjaftueshme, nuk ekziston synimi apo plani, si planifikon
5 Prokuroria që ta vërtetojë këtë në nivelin e Shtabit të
6 Përgjithshëm, i cili është akoma dhe më tej ndaj ngjarjeve në
7 terren?

8 Dhe Prokuroria pse e bën këtë gjë, pra, pse i kërkon
9 këtij Trupi Gjykues që të marrë vendime të cilat janë
10 tërësisht në kundërshtim me TPNJ-në.

11 Prokuroria injoron përfundimet e TPNJ-së dhe komunikatat
12 dhe deklaratat publike. Janë të njëjta komunikata dhe
13 deklarata publike që përdori Prokuroria të cilat në fakt janë
14 përdorur dhe në TPNJ.

15 Prokuroria injoroi konstatimet e TPNJ-së sa i takon
16 krimeve kundër njerëzimit. Në Limaj, Trupi Gjykues arriti në
17 përfundimin se: "Mjetet dhe metodat e përdorura nga UÇK-ja ...
18 nuk janë karakteristike të një sulmi të drejtuar kundër
19 popullsisë civile".

20 Prokuroria gjithashtu injoron konstatimet e TPNJ-së
21 lidhur me fillimin dhe fundin e konfliktin të armatosur.

22 Prokuroria duhet që t'i provojë secilin prej këtyre
23 çështjeve përtej dyshimit të arsyeshëm. Në realitet,
24 Prokuroria thjesht parashtron të njëjtën çështje dhe shpreson
25 që të merret një përfundim ndryshe. Kjo nuk mund të ndodhë

1 sepse konstatimet autoritative të TPNJ-së si minimum të paktën
2 do të përfaqësojnë alternativa të arsyeshme lidhur me faktet
3 që do ta parandalojnë Prokurorinë që të vërtetojë provat e
4 saj.

5 Së pesti, të nderuar Gjykatës, Prokuroria anashkalon
6 domethënien e mbështetjes së NATO-s për UÇK-në.

7 Një tipar i pamohueshëm në këtë çështje është mbështetja
8 e NATO-s në Kosovë për UÇK-në. NATO u angazhua me UÇK-në në
9 nivele të ndryshme. Pa sulmet ajrore të NATO-s, forcat serbe
10 nuk do të ishin larguar nga Kosova.

11 Në të njëjtën kohë, Prokuroria pretendon që kishte një
12 plan të përbashkët kriminal që ajo tha para dy ditësh që ky
13 plan nuk ishte sekret. U tha në publik kjo gjë. Kjo do të
14 thoshte që NATO-ja mbështeti një ndërmarrje kriminale të
15 njohur. Kjo nuk mund të jetë kurrsesi e drejtë, kjo është pa
16 diskutim e gabuar.

17 Ndryshe nga NATO-ja, z. Krasniqi nuk kishte as satelitë,
18 as aeroplanë, as komunikime të përgjuara. Shikoni pak
19 rrethanat. Bëhet fjalë për një mësues, për një historian, nuk
20 bëhet fjalë për një ushtarak profesionist. Kufizimet e tij
21 ishin të ditura. Përderisa emri i tij njihej si për njerëzit
22 ashtu edhe për forcat serbe, ai e dinte që ishte në shënjestër
23 dhe për një pjesë të konsiderueshme të periudhës së aktakuzës
24 ka udhëtuar në sekret duke qëndruar me familjarë dhe me
25 familje që ai i besonte. Ai nuk kishte mjete për të njohur,

1 për të qenë në dijeni për krimet e kryera në këto vende.

2 Së pesti [sipas përkthimit], Prokuroria prezumon që
3 ndodhja e krimeve në vende të ndryshme mund të jetë
4 konsistente vetëm me një plan ose mund të përputhet vetëm me
5 një plan kriminal të përbashkët.

6 Në fund të çështjes, Prokuroria mund të ketë vërtetuar që
7 mund të kenë ndodhur krime të caktuara në pjesë të caktuara të
8 Kosovës. Historia ka treguar që konflikti krijon një mjedis në
9 të cilin individët ndonjëherë mund të kryejnë krime. Edhe në
10 ushtritë shumë të organizuara ndonjëherë është absolut -- nuk
11 është e mundur që të parandalohen të gjitha krimet. Të nderuar
12 Gjykatës, vitet e fundit ka pasur raporte krimesh në trupat
13 kanadeze në Somali ose trupat australiane në Afganistan dhe
14 lista mund të zgjatet pa fund, megjithatë është çështje tjetër
15 që të pretendosh që kishte një politikë të organizuar ose plan
16 të organizuar pas këtyre krimeve.

17 Në këtë çështje, vërtetimi i krimeve të cilat mund të
18 jenë kryer nga luftëtarët e UÇK-së ose njerëzit e ndryshëm me
19 uniforma të UÇK-së nuk mjafton që të hedhësh fajin dhe të
20 akuzosh Jakup Krasniqi. Kjo ishte një ushtri vullnetare e cila
21 u mbledh. Dhe, ishte absolutisht shumë larg nga ushtria e
22 Shteteve të Bashkuara për shembull dhe nuk është se kishte --
23 nuk ishte një ushtri konvencionale. Nuk kishin uniforma edhe
24 kur ishin të uniformuar, uniformat nuk ishin të njëjta. Kështu
25 që të pretendosh mbi këtë bazë nuk ka kuptim.

1 Së fundi, në fakt krimet mund të kenë ndodhur në vende të
2 ndryshme në kohë të ndryshme, kjo në vetvete nuk vërteton
3 sjelljen dhe pretendimin e Prokurorisë. Në qoftë se kishte një
4 ndërmarrje të përbashkët për të kryer krime kundër një klase,
5 kundër një grupi kundërshtarësh, pse nuk janë kryer në mënyrë
6 konsistente gjatë gjithë periudhës së aktakuzës në secilin
7 prej vendeve këto krime? Jo vetëm kaq por provat do të
8 tregojnë një valë veprash në të gjitha vendet. Dhe provat do
9 të nxjerrin në pah një sërë përgjigjesh spontane lokale ndaj
10 situatave që herë pas here shfaqeshin në nivel lokal.

11 Të nderuar Gjykatës, këto gjashtë gabime janë thjesht
12 shembuj ilustrues për t'ju treguar sesa e brishtë është
13 çështja e Prokurorisë. Ndërkohë që do të shpalosen provat para
14 Trupit Gjykues më tepër do të dalë në pah, ne jemi besimplotë
15 që në fund të çështjes së Prokurorisë, ne do të kemi mundësinë
16 që të bëjmë të njëjtin parashtrim të fortë siç po bëjmë deri
17 tani, që nuk ka asnjë provë të besueshme që e lidh Jakup
18 Krasniqi me asnjë krim. Që nuk ka prova të besueshme për
19 qëllimin kriminal të përbashkët. Dhe nuk ka arsye që kërkojnë
20 Mbrojtjen që t'i përgjigjet çështjes së Prokurorisë.

21 Shqiptarët e Kosovës nuk kishin asnjë zgjidhje tjetër por
22 të vetorganizoheshin, që të mbroheshin, që ofronin mbështetje
23 dhe mbrojtje për të gjithë qytetarët në arë vend. Shqiptarët e
24 Kosovës atëherë kishin të drejtën dhe, kanë edhe sot e kësaj
25 dite, të drejtën që të trajtohen në mënyrë të barabartë. Jemi

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Deklarata jo nën betim nga i akuzuari Krasniqi (Seancë e hapur) Faqe 20

1 besimplotë, të nderuar Gjykatës, që në këtë Gjykatë do të
2 jepen, do të zbatohen të drejtat themelore. Sepse standardet
3 që ne aplikojmë për ta janë standarde që aplikojmë dhe për
4 veten tonë. Për këtë arsye ne jemi fatlum sot që kemi gjyqtarë
5 të pavarur, të paanshëm me përvojë domethënëse që ne besojmë
6 që do t'i analizojnë provat dhe të mos i japin asnjë peshë
7 politikës apo zhurmës nga lagje të caktuara që duhet të ketë
8 më shumë kosovarë që të dënohen.

9 Tani, të nderuar Gjykatës, në qoftë se më lejoni, dua t'i
10 jap fjalën z. Jakup Krasniqi.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Krasniqi,
12 keni të drejtën të bëni një deklaratë jo nën betim dhe mund të
13 merrni fjalën.

14 I AKUZUARI KRASNIQI: Po.

15 I nderuari Kryetar i gjyqit, të nderuar Gjyqtarë, më
16 lejoni që në fillim të këtij procesi të them disa fjalë për
17 jetën time, jo për të mbrojtur vetveten nga njollosja që më
18 bëhet në këtë akuzë, por për të ndriçuar atë që më duket e
19 domosdoshme për të kuptuar pafajësinë time të plotë.

20 Jam lindur më 1 janar të vitit 1951 në fshatin Negroc në
21 rajonin e Drenicës. Në familje kemi qenë tetë vëllazër dhe tri
22 motra. Motra e madhe nuk jeton më. Unë jam vëllai i dytë nga
23 mosha. Baba im, Januz Krasniqi, ishte i arsimuar dhe me pak
24 angazhim do të mund të ishte bërë mësues, por ai nuk u pajtua
25 me regjimin e kohës dhe zgjodhi të punojë tokën dhe të

1 përkujdesej për arsimin e fëmijëve të tij.

2 Arsimi ka qenë gjithmonë i rëndësishëm për familjen tonë.
3 Përveç vëllait të madh që ka punuar jashtë Kosovës dhe dy
4 motrave të mëdha që përfunduan vetëm shkollimin e obligueshëm,
5 ne të tjerët vazhduam rrugëtimin e përgatitjes profesionale të
6 arsimit.

7 U lindi gjashtë vite pas janarit të tmerrshëm të vitit
8 1945, kur forcat e armatosura të regjimit komunist kryen
9 njëherën ndër krimet më të tmerrshme të gjenocidit të asaj kohe,
10 vrasjen e mijëra shqiptarëve, burgosjen e shumë të tjerëve dhe
11 dëbimin e programuar të shqiptarëve për në Turqi. Dhe të
12 gjitha këto tmerre ndodhen pas përfundimit të Luftës së Dytë
13 Botërore dhe premtimeve të shumta të partisë komuniste të
14 Jugosllavisë që do të respektonte të drejtën e popullit
15 shqiptar për vetëvendosje.

16 Por ju kujtoj se në përputhje me këto orientime politike
17 të bartësve të luftës nacional çlirimtare në Konferencën e
18 Bujanit të mbajtur më 31 dhjetor 1943 dhe 1-2 janar 1944
19 delegatët e Kosovës miratun rezolutën nëpërmjet së cilës
20 shprehnin vullnetin politik të popullit të saj, që pas
21 përfundimit të luftës Kosova dhe Rrafshi i Dukagjinit të
22 bashkoheshin me Shqipërinë. Mirëpo, në vend të respektimit të
23 këtij vendimi politik, sapo përfundoi lufta, regjimi komunist
24 i Jugosllavisë imponoi administrimin ushtarak në Kosovë dhe pa
25 proces gjyqësor ekzekutoi mijëra shqiptarë. Gjendja e

1 jashtëzakonshme dhe administrimi ushtarak në Kosovë vazhdoi
2 deri në korrik të vitit 1945 kur në të ashtuquajturin Kuvend
3 të Prizrenit u vendos që Kosova t'i aneksohej Serbisë.

4 I përmenda këto fakte për të ilustruar rrethanat në të
5 cilat kam lindur dhe jam rritur. Dua të theksoj se që në
6 fëmijërinë time të hershme kam qenë i rrethuar me njerëz të
7 cilët i kanë mbijetuar politikës së gjenocidit të Serbisë.
8 Familjarët e të cilëve ishin vrarë, plagosur, burgosur apo të
9 cilëve u ishin shkatërruar shtëpitë dhe konfiskuar pronat.

10 Nga historitë e tmerrshme që rrëfeshin në familjen time
11 dhe ato që tregoheshin nga shokët e fëmijërisë sime, si edhe
12 ajo që kam parë dhe dëgjuar më vonë kudo që kam shkuar, më
13 kanë bërë që të kuptoj se prapa propagandës për parajsën
14 jugosllave të barazisë së kombeve qëndronte një ferr i
15 tmerrshëm në të cilën shqiptarët e Kosovës u përballën, jo
16 vetëm gjatë disa dekadave të regjimit komunist, por dhuna
17 sistematike ndaj tyre u zbatua për më shumë se një shekull që
18 nga koha e krijimit të shteteve në Ballkan në fund të
19 shekullit 19 dhe në fillim të shekullit 20.

20 Kur isha 5-6 vjeç, në dimrin e vitit 1956, 1957, nën
21 pretekstin e aksionit të grumbullimit të armëve nga shqiptarët
22 e Kosovës, regjimi komunist jugosllav filloi një valë të re të
23 dhunës së dizajnuar për dëbimin e shqiptarëve nga trojet e
24 tyre. Babai im ishte viktimë e kësaj dhune. Më kujtohet si sot
25 kur babai im u kthye në shtëpi i rrahur për vdekje dhe, në një

1 qoshe të shtëpisë sonë nëna ime mendohej që t'ia lehtësonte
2 dhembjet e torturës njerëzore që ishin ushtruar ndaj tij. Edhe
3 sot e kësaj dite, më kanë mbetur të ngulitura në kujtesën time
4 përpëlitjet e tmerrshme të babait tim. Përveç torturave në
5 fjalë, gjatë gjithë jetës së tij ai ka qenë i përndjekur dhe
6 ka përjetuar trauma tjera edhe më të mëdha. Burgosja ime ishte
7 shumë e vështirë për të.

8 Familja ime besonte që neve na duhej arsimi në mënyrë që
9 të largojmë diskriminimin me të cilin si shqiptarë po
10 përballëshim në secilin segment të jetës shoqërore dhe
11 politike. Megjithëse përfundova shkollën fillore me rezultate
12 të shkëlqyera, unë nuk munda të regjistrohesha në shkollë të
13 mesme dhe për një vit kam ruajtur delet tona. Më kujtohet që
14 babai im insistojte. Vazhdoj shkollimin në vitin vijues 1966,
15 kur u bë më i lehtë regjistrimi pas rënies së Aleksandër
16 Rankoviçit. Më vonë mësuesisë ju përkushtova. Pas mësuesisë ju
17 përkushtova studimeve universitare në fushën e historisë në
18 Universitetin e Prishtinës. Pas përfundimit të studime,
19 fillimisht kam punuar si mësues në fshatin tim e pastaj si
20 profesor në gjimnazin e Drenasit dhe të Skënderajt.

21 Por, isha i vetëdijshëm se të gjitha dijet e botës nuk do
22 të ishin të mjaftueshme për të ndryshuar gjendjen e
23 shqiptarëve në Jugosllavi pa një organizim të duhur dhe të
24 përgjithshëm vullnetar të gjeneratës sime. Prandaj, u bëra
25 pjesë e organizatës klandestine Grupi Revolucionar i Kosovës,

1 që kishte për qëllim çlirimin dhe bashkimin e Kosovës me
2 Shqipërinë. Dhe kjo ndodhi në vitin 1973.

3 Më 1981, për arsye të pakënaqësive të mëdha rinia e
4 Kosovës organizoi demonstrata të cilat njihen si pranvera
5 shqiptare e vitit 1981. Ky ishte një mobilizim i përgjithshëm
6 i njerëzve në Kosovë për të kërkuar të drejta të barabarta me
7 kombet e tjera që përbënin Federatën e Jugosllavisë. Këto
8 demonstrata u shtypën me dhunë nga forcat policore ushtarake
9 të atij vendi.

10 Edhe të dhënat zyrtare të demonstratave të vitit 1981
11 tregojnë se të rinjtë u rrahën, të 11 të rinj u vranë, 285 u
12 plagosën dhe qindra mijëra u arrestuan dhe më vonë do të
13 dënoheshin. Ashtu si u përdor dhuna fizike dhe psikike ndaj
14 mijëra të burgosurve politikë u ushtru dhunë e tmerrshme edhe
15 ndaj meje.

16 Gjatë dy proceseve hetuese që janë zhvilluar ndaj meje në
17 vitin 1981 dhe në vitin 1982, kam përjetuar tmerrret që nuk
18 përshkruhen me fjalë. Duart dhe këmbët i kisha gjithmonë të
19 ënjtura nga rrahjet. Dhe pas dy proceseve të hetuesisë, më
20 dënuan dy herë. Herën e parë në vitin 1981, më dënuan me 14
21 vjet burg dhe herën e dytë në vitin 1982, me 15 vjet burg.

22 I përmenda torturat që ushtruan ndaj meje për të
23 nënvijëzuar një fakt të pakontestueshëm: asnjë hetues, asnjë
24 prokuror dhe asnjë gjyqtar i ish-Jugosllavisë të cilët ishin
25 përgjegjës për torturat fizike dhe psikike që përjetova gjatë

1 asaj kohe nuk ka qenë as objekt kritike në shkrimet e mia. I
2 kam lënë të qetë t'i brejë ndërgjegjja për veprimet e tyre
3 kriminale.

4 Unë nuk e kuptoj logjikën e akuzës së tanishme kundër
5 meje. Ndaj popullit tonë është ushtruar dhunë sistematike,
6 vrasje, burgosje, tortura. dëbime. Unë e urrej dhunën,
7 vrasjet, burgosjet, torturat, dënimet jo vetëm se janë
8 ushtruar ndaj popullit tonë dhe ndaj meje personalisht, por
9 sepse i konsideroj si tepër të ulta dhe çnjerëzore. Çdonjëri
10 që flet të vërtetën do t'ju thotë se unë, Jakup Krasniqi,
11 asnjëherë nuk kam qenë i përfshirë në asnjë vrasje, në asnjë
12 burgosje, në asnjë formë të presionit ndaj kujtdo qoftë.

13 Integriteti im intelektual dhe njerëzor më ka mundësuar
14 ta kem të qartë se cilat mjete duhet përdorun për realizimin e
15 çlirimit kombëtar në luftë kundër atyre që përpiluan dhe
16 zbatuan gjenocid ndaj nesh.

17 Pas më shumë se dhjetë vjetëve vuajtje dënimi më 23
18 korrik 1991 u lirova nga burgu i Novi Sadit. Mirëpo, kjo nuk
19 nënkuptonte daljen në liri. Populli shqiptar i Kosovës ishte
20 populli më i robëruar në Evropë. Ishte populli i ndaluar, siç
21 përkufizoj intelektualin i madh shqiptar akademiku Qosja,
22 prandaj nga muret e ndërtesave të burgut të Novi Sadit që
23 ishte i mbushur plot e përplot me shqiptarë dola në burgun me
24 2 milionë shqiptarë që quhej Kosovë. Hyra në burgun në Kosovë
25 në kohën kur regjimi i Slobodan Milosheviçit kishte vënë në

1 zbatim politikën e aparteidit si fazë paraprake e gjenocidit
2 të planifikuar kundër shqiptarëve.

3 Menjëherë pas kthimit në Kosovë, u angazhova në kuadër të
4 strukturave të Lidhjes Demokratike të Kosovës në Drenas. Në
5 atëkohë LDK-ja angazhohej që të organizonte një sistem
6 funksional paralel të jetës politike dhe institucionale në
7 Kosovë për të zbutur pasojat e politikës së aparteidit të
8 instaluar nga regjimi i Beogradit. Në funksion të krijimit të
9 institucioneve qendrore në vitin 1992 u organizuan zgjedhjet
10 për kuvendin e Kosovës. Në ato zgjedhje fitova 96 për qind të
11 votave të qytetarëve të zonës sime dhe u zgjodha deputet i
12 atij kuvendi.

13 Gjatë viteve në vijim, si kuadër i Lidhjes Demokratike të
14 Kosovës, kam udhëhequr këshillin e financave në Drenas. Ndërsa
15 nga muaji prill i vitit 1996 e deri në fillim të luftës së
16 armatosur në vitin 1998, kam qenë kryetar i këshillit për
17 arsim në Drenas. Në këtë kontekst, po përmend edhe funksionin
18 e kryetarit të degës së Lidhjes Demokratike në Drenas, që kam
19 ushtruar nga fundi i vitit 1997 deri në prill të vitit 1998.
20 Funksion që më mbante në kontakt të vazhdueshëm me strukturat
21 udhëheqëse të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

22 Është absurde që të akuzohem për persekutimin e anëtarëve
23 të Lidhjes Demokratike të Kosovës ose si pjesë e një qëllimi
24 të përbashkët për të sulmuar Lidhjen Demokratike të Kosovës.
25 Unë vetë isha anëtar i Lidhjes Demokratike të Kosovës.

1 Familjarët e mi ishin anëtarë të Lidhjes Demokratike të
2 Kosovës. Bashkëveprimtarët dhe bashkëluftëtarët e mi ishin
3 anëtarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Vetëm një mendje e
4 çoroditur mund t'i ketë lindur ideja se unë kam mundur të jem
5 pjesë e persekutimit tim, të familjarëve të mi dhe
6 bashkëveprimtarëve dhe bashkëluftëtarëve të mi.

7 Të nderuar Gjyqtarë, tërë jetën më ka shoqëruar toleranca
8 ndaj mendimit ndryshe. Po ju përmendi një shembull që nxjerrë
9 në shesh të pavërtetat e pretendimeve të një akuze të tillë.
10 Si shumë familjarë të tjerë edhe vëllai im, Agimi Krasniqi, ka
11 qenë pas luftës, gjatë luftës, dhe pas përfundimit të saj
12 anëtar i Lidhjes Demokratike të Kosovës. Në zgjedhjet e lira
13 të organizuara pas luftës, vajza e tij, mbesa ime, Mimoza
14 Krasniqi, si anëtare e LDK-së u zgjodh në asamblenë komunale
15 të Drenasit.

16 Pa marrë parasysh se pas përfundimit të luftës kemi
17 vepruar në parti politike të veçanta, unë ruaj kujtimin,
18 respektin për veprimtarët e Lidhjes Demokratike me të cilët
19 kemi vepruar në rrethana tejet të rënda.

20 Përpyjekjet për të gjetur një zgjidhje paqësore për
21 çështjen e Kosovës dështuan për shkak të regjimit të
22 Beogradit, i cili kishte përgatitur një plan gjenocidal
23 prandaj nuk shfaqti as interesin më të vogël për të shmangur
24 luftën e armatosur. Kur filloi lufta, në vende që të
25 ballafaqoheshin me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, forcat e

1 armatosura të saj çfarë mbeti prej federatës jugosllave të
2 kontrolluara plotësisht nga regjimi i Millosheviçit ndërmorën
3 ofensiva kundër vendbanimeve shqiptare duke masakruar fëmijë,
4 gra, pleq dhe duke shkatërruar shkolla, shtëpi kulture,
5 biblioteka, objekte fetare dhe gjithçka që ishte lidhur me
6 identitetin e shqiptarëve.

7 Si kryetar i Lidhjes Demokratike në Drenas, kam ndjekur
8 nga afër krimet në Likoshan, në Qirez e në Prekaz dhe shumë
9 krime të tjera të llahtarshme që kanë ndodhur e të cilat ishin
10 akte të pastra gjenocidi. Në ato ditë të vështira i kam
11 vizituar këto familje pas vrasjes së anëtarëve të familjeve të
12 tyre.

13 Në ceremoninë mortore në Likoshan, kam mbajtur fjalën në
14 emër të Lidhjes Demokratike dhe të gjitha partive politike
15 lokale. Unë kam parë me sytë e mi se në banimet të cilat
16 regjimi i kishte targetuar shumica e anëtarëve të familjeve
17 ishin ekzekutuar në Likoshan dhe Qirez, si Ahmet Ahmeti, Gani
18 Ahmeti, Hilmi Ahmeti, Hamza Ahmeti, Driton Ahmeti, Naim
19 Ahmeti, Lumni Ahmeti, Shemsi Ahmeti, Bastri Ahmeti, Elhami
20 Ahmeti. Të gjithë anëtarë të një familjeje. Ilir Nebiu, Rukie
21 Nebihu, Xhemshi Nebihu, Beqir Sejdiu, Nazmi Sejdiu, Bedri
22 Sejdiu, Bekim Sejdiu.

23 Ndërsa në Prekaz, përveç 59 njerëzve që u ekzekutuan, unë
24 po i lexoj emrat vetëm të fëmijëve: Blerina Jashari, 7-
25 vjeçare; Fatime Jashari, 9-vjeçare; Igballe Jashari, 11-

1 vjeçare; Abdullah Jashari, 16-vjeçar; Blerim Jashari, 12;
2 Bujar Jashari 5-vjeçar; Igball Jashari, 13-vjeçar; Kushtrim
3 Jashari, 13-vjeçar; Lirie Jashari, 15-vjeçare; Valdete
4 Jashari, 15-vjeçare. Gjithsej të vrarë thashë se ishin 59.

5 Nuk më vjen turp të deklaroj publikisht se kam qarë kur
6 pashë në një depo të materialeve ndërtimore në hyrje të
7 Skënderajt gjithë ata njerëz të vrarë të familjes Jashari të
8 Prekazit.

9 Adem Demaçi, i burgosur politik për afër 30 vjet që ka
10 marrë dhe çmimin Sakharov me vërejtje se po qaja dhe pasi më
11 shprehu ngushëllime më tha "Jakup, nuk ka fitore pa luftë dhe
12 sakrifica".

13 Unë e dija se ky ishte çmimi i lirisë. U përpoqa të ta
14 mbaja veten, por nuk mundja. Nuk po qaja për Ademin, Hamzën
15 dhe Shaban Jasharin që ata tani janë legjendë e lirisë. Unë po
16 qaja për fëmijët, për pasardhësit e kombit tim, për ata që nuk
17 patën mundësi për të jetuar asnjë ditë të një fëmijërie.

18 Në ato momente, më është bërë e qartë se nuk mund të
19 jetoja më me kokën e futur në zall si struci. Ishte e qartë që
20 Serbia kishte filluar implementimin e planit gjenocidal. Nuk
21 ishte njerëzore që t'u kthehej shpina njerëzve që
22 ballafaqoheshin me pasojat e gjenocidit. Ishin momente
23 vendimtare. Në ato momente thashë: Liri o vdekje por jo kurrë
24 më nën sundimin e politika gjenocidale të Serbisë.

25 Në këtë kohë, saktësisht në qershorin e vitit 1998, më

1 është propozuar që të dal publikisht si zëdhënës i UÇK-së. Nuk
2 hezitova për asnjë moment që të marrë përsipër një detyrë të
3 tillë dhe pse rreziku ishte i madh. Isha krejtësisht i
4 vetëdijshëm se paraqitja ime publike, identiteti im si
5 zëdhënësi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës do të vendoste dhe
6 familjen time në rrezik. Dalja ime publike, familjen time e
7 kishte bërë target për t'u shkatërruar, siç ishte në rrezik
8 dhe çdo familje shqiptare në Kosovë. Kjo është arsyeja sepse
9 sot nuk do të flas për fatin e familjes sime. As nuk do të
10 flas për babain tim i cili vdiq për shkak të pasojave të
11 torturave serbe. Sepse të gjithë shqiptarët, pa marrë parasysh
12 dallimet politike, fetare, gjinore apo të moshës ishin objekt
13 i shkatërrimit i planit gjenocidal të Serbisë. Sa për
14 ilustrim, po përmendi se në funksion të qëllimit për të
15 shkatërruar shqiptarët, si të tillë forcat serbe vranë 1392
16 fëmijë në mesin e të cilëve kishe dhe foshnja në djep, 1739
17 gra dhe mbi 10,000 civilë të tjerë.

18 Përkundër të gjitha të metave dhe vështirësive që na kanë
19 karakterizuar gjatë luftës, në rolin tim si zëdhënës i UÇK-së
20 jam përpjekur të krijoj përshtypje se jemi një strukturë e
21 organizuar mirë sepse kjo ishte mënyra e vetme për të mbajtur
22 gjallë shpresat për një rezistencë të mirëfilltë prandaj
23 deklaratat e mia duhet të shihen në funksion të propagandës
24 për të afirmuar luftën tonë çlirimtare. Përtej aspiratave për
25 bashkim kombëtar, ne gjithmonë e kemi dëshiruar, deklaratat e

1 kësaj natyre gjatë luftës ishin në funksion të ngjalljes së
2 shpresave se bashkimi me Shqipërinë do të rriste gjasat për
3 fitore.

4 Kësaj radhe nuk do të zgjatem për përshkrimin e luftës
5 sonë çlirimtare e as për kontaktet e mia diplomatike si
6 përfaqësues politik i UÇK-së e as për konferencën e Rambujesë
7 të cilën ne e nënshkruam në mënyrë që t'i jepnim një mundësi
8 paqes dhe pse marrëveshja nuk ishte e mirë për ne. Sa herë
9 është varur nga ne, ne paqes i kemi hapur të gjitha portat. Ne
10 udhëheqim nga porosia e Skënderbeut, i cili pat thënë: Të
11 kërkosh luftë është çmenduri, por t'i përgjigjesh asaj kur të
12 imponohet është urti.

13 Gjithashtu nuk do të përshkruaj rrugën time politike pas
14 çlirimit të vendit, vendosjes së administrimit të UNMIK-ut,
15 negociatave për statusin final të Kosovës në Vjenë të
16 udhëhequra nga Presidenti Martti Ahtisaari dhe angazhimin tim
17 në ndërtimin e Republikës së Kosovës si një shtet demokratik i
18 cili plotësisht respekton të drejtat dhe liritë e minoriteve.
19 Arsyeja është se i gjithë aktiviteti im publik dhe ky është
20 një fakt i njohur, të gjithë ata që janë marrë me çështjen e
21 Kosovës, vendorë e ndërkombëtarë, e dinin rolin dhe
22 kontributin tim në atë proces.

23 Nëse në rrugëtimin tim politik ka një gjë që nuk ka
24 logjik, është aktakuza ngritur nga ZPS-ja. Përmbajtja e akuzës
25 më ka lënduar më shumë sesa torturat mizore dhe dënimi me burg

1 nga regjimi serb e jugosllav.

2 Preteksti për këtë aktakuzë u gjet në librin e Carla Del
3 Ponte dhe në të ashtuquajturin raporti i Dick Marty për gjoja
4 trafikim organesh nga ana e UÇK-së. Pas hetimeve të shumta
5 disa vjeçare, nga Taks-Forca Speciale e EULEX-it në krye me
6 Clint Williamson, në ekipin hetues të të cilit ishin përfshirë
7 ekspertë nga 18 shtete të BE-së, Kanadaja dhe Shtetet e
8 Bashkuara të Amerikës nuk u gjet asnjë provë e vetme. Dhe,
9 rrjedhimisht, një akuzim i tillë nuk është pjesë e akuzës së
10 ZPS-së.

11 Për fund, si ilustrim, po përmendi njërin nga rastet më
12 të mediatizuara të vrasjes së civilëve serbë në Kosovë. Më 14
13 dhjetor 1998, 42 ushtarë të UÇK-së u vranë në afërsi të
14 kufirit me Shqipërinë. Në mbrëmjen e asaj dite, në kafenenë
15 Panda në Pejë u vranë gjashtë të rinj serb dhe malazezë.
16 Vrasjet e këtyre të rinjve u interpretuan si një akt
17 hakmarrjeje nga UÇK-ja. Gjatë përpjekjeve për të gjetur
18 personat fajtorë, qindra shqiptarë të pafajshëm u torturuan
19 derisa ata detyruan gjashtë të rinj ta pranojnë se e kanë kry
20 krimin të cilin nuk e kishin bërë. E vërteta për këtë akt të
21 tmerrshëm del në shesh pas 15 viteve. Vuk Draskoviç, i cili
22 gjatë luftës në Kosovë ka qenë zëvendëskryeministër i
23 Jugosllavisë në një intervistë për gazetën Beogradasi Kuril të
24 datës 18 janar 2014 të titulluar "Milosheviçi kishte urdhëruar
25 Radetan dhe Legian për të vrarë fëmijë serbë" deklaroi, po

1 citoj:

2 "Vendimi përsëri në krime kundër serbeve në Kosovë dhe
3 shqiptarëve që mbështesnë Serbinë dhe fajësinë e UÇK-së u
4 soll nga Milosheviçi dhe shtabi i tij strategjik. Ishte i
5 vendosur që shërbimi i sigurimit shtetëror do të kryente disa
6 sulme terroriste për të cilat UÇK-ja do të fajësohej".

7 Artikulli ishte i titulluar edhe njëherë po e ceki,
8 "Milosheviçi kishte urdhëruar Radetan dhe Legian për të vrarë
9 fëmijë serb". Jo vetëm serb por dhe shqiptarë.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Krasniqi,
11 ju mbaroi koha.

12 I AKUZUARI KRASNIQI: Jam në përfundim.

13 Dëshmitë e njërit nga protagonistët kryesor shtetëror të
14 kohës ku ndaj shqiptarëve zbatohet politika e gjenocidit duhet
15 të ndërgjegjësojnë çdo njeri për faktin se prapa vrasjes së
16 civilëve të gjitha përkatësive etnike në Kosovë qëndron
17 regjimi i Beogradit.

18 Unë kurrë nuk kam qenë në shërbim të ndonjë politike të
19 krimit. Kjo është arsyeja sepse kam qenë rehat me ndërgjegjen
20 time njerëzore. Kam jetuar një jetë me dinjitet dhe dua të
21 vdes me dinjitet. Në jetën time asnjëherë nuk kam kryer ndonjë
22 vepër kriminale as para luftës, as gjatë luftës, as pas
23 luftës. Asnjëherë nuk kam qenë përfshirë në vepra kriminale as
24 me veprim, as me mosveprim, as me nxitje. Gjithmonë kam qenë,
25 kam vepruar ndershmërisht për liri dhe bashkim kombëtar që

1 kanë qenë qëllimi im jetësor. Prandaj kam qenë dhe jam krenar
2 për veprimtarinë time politike. Si në të kaluarën edhe sot jam
3 ballëhapur para çdo njeriu dhe shumë i lumtur që kam arritur
4 edhe në rrethana tepër të rënda, ta ruaj integritetin tim
5 njerëzor, intelektual, prandaj sinqerisht jam i qetë.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Krasniqi.

7 I AKUZUARI KRASNIQI: Të nderuar Gjyqtarë, i nderuar
8 Kryetar i gjyqit, i kam edhe tri lutje për Trupin tuaj
9 Gjykues.

10 Lutja e parë: Mos lejoni që të keqpërdoren mendimet e
11 opinionet individuale të pasluftës për kohën e luftës.

12 Kërkesa e dytë: Mos lejoni që shënimet e mia, përshkrimet
13 e librave të mia shkencore dhe publistike të përdoren si
14 dëshmi për vepra penale siç pretendon ZPS-ja.

15 Dhe, e treta, për komunikatat. Unë po lexoj atë që është
16 thënë në vendimin për lirimin e Fatmir Limës në Tribunalin
17 Ndërkombëtar të Hagës, komunikatat si material propagandistik
18 ishin rritja e respektit për UÇK-në dhe autoritetit të saj me
19 qëllim që njerëzit të besonin në të dhe të anëtarësoheshin.
20 Paragrafi 118, në aktvendimin e TPNJ-së për Fatmir Limën. E
21 njëjta gjë thuhet dhe në aktvendimin lirus për z. Ramush
22 Haradinaj.

23 Ju lus që materialet mos të keqpërdoren, se unë mendoj që
24 shënimet e mia për të shkruar libër Prokuroria i ka
25 keqpërdorur skajshmërisht. Në familjen time ka marrë materiale

1 të shumta, ka marrë dhe letrat e mia që i kam dërgu nga burgu,
2 por ato nuk janë kurrfarë dëshmie për të cilat po pretendon
3 Prokuroria në këtë aktakuzë.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Krasniqi.

5 I AKUZUARI KRASNIQI: Ju faleminderit për vëmendjen dhe më
6 falni, po ma e gjatë është aktakuza. Fjala ime mendoj që është
7 tepër e shkurtër në raport çka duhet të them për jetën dhe
8 veprën time jetësore.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Uluni, ju
10 lutem.

11 Znj. Alagendra, klienti juaj ka përdorur edhe kohën tuaj,
12 kështu që ju lutem sa më shkurt.

13 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Do flas shumë shkurt. Ne jemi
14 prapë brenda një orari që kishim caktuar.

15 Të nderuar Gjykatës, ky është personi që thotë Prokuroria
16 që synonte të vriste, torturonte apo trajtonte në mënyrë
17 mizore civilët e pafajshëm. Në këtë proces do të shihni kush
18 është në të vërtetë Jakup Krasniqi. Është një person i
19 arsimuar, i rritur me vlera dhe që sillet me dinjitet. Është
20 shumë njerëzor. Pas të gjitha vuajtjeve që pësoi, ai nuk mund
21 të qëndronte duarkryq kur personat torturoheshin apo rriheshin
22 civilët.

23 Jakup Krasniqi nuk është personalisht përgjegjës për
24 kryerjen e asnjë prej veprave penale për të cilat akuzohet.
25 Nuk ka qenë pjesë e ndërmarrjes kriminale të përbashkët siç

1 pretendon Prokuroria. Nuk ka pasur marrëveshje për të kryer
2 krime. Qëllimi i tij ishte të siguronte krijimin e një kombi
3 të sigurtë dhe të lirë për shqiptarët e Kosovës të pavarur nga
4 shteti serb.

5 Pas 25 vitesh pas fillimit të konfliktit të armatosur,
6 pas vitesh hetimesh, pas të gjitha përpjekjeve të raportit të
7 Dick Marty, pas të gjitha përpjekjeve të TPNJ-së e të gjitha
8 përpjekjeve të EULEX-it, jemi duke filluar këtë gjykim dhe
9 kemi një fakt të pakundërshtueshëm: asnjë dëshmitar i
10 besueshëm, asnjë burrë, grua apo fëmijë, asnjë ndërkombëtar
11 nuk mund të thotë që Jakup Krasniqi ka qenë i pranishëm dhe ka
12 marrë pjesë në marrjen në pyetje, torturën, keqtrajtimin apo
13 vrasjen e ndonjë civili. As në emrin e tij. As në praninë e
14 tij. Kjo është prova e prokurorisë, të nderuar Gjykatës. Jakup
15 Krasniqi nuk është ky person dhe për këtë arsye, në fund të
16 kësaj çështjeje, ne kemi besim se do të ketë vetëm një
17 rezultat: Ai do të shfajësohet.

18 Faleminderit.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Këtu mbyllim
20 dhe deklaratat hapëse të palëve dhe pjesëmarrësve. Do të
21 takohemi të martën, më 11 prill, në orën 9.00, për të filluar
22 me prezantimin e provave nga ana e ZPS-së.

23 Trupi Gjykses dëshiron të kujtojë palët dhe pjesëmarrësit
24 se në bazë të paragrafit 78 të urdhrit për Zhvillimin e
25 Procesit Gjyqësor pala që ka thirrur dëshmitarin duhet të

1 hedhë më Legal Workflow materialet në rendin përkatës ku
2 përfshihen dokumentet që synon të përdorë me atë dëshmitar.
3 Dhe kjo nuk duhet të jetë më vonë se 24 orë përpara se të
4 fillojë dëshminë dëshmitari.

5 Për qartësi, Trupi Gjykues vëren se afati 24 orë vlen
6 edhe në qoftë se nuk është ditë pune apo është pushim.
7 Materialet sa i takon dëshmitarit të parë duhet të ngarkohen
8 në Legal Workflow jomë vonë se të hënën, 10 prill 2023, ora
9 9.00 për këtë rast.

10 Sot mbyllim seancën publike të ditës së sotme.
11 Faleminderit palëve, pjesëmarrësit dhe Zyrën Administrative
12 për pjesëmarrjen e tyre. Faleminderit përkthyesit,
13 stenografët, teknikët dhe personelin e sigurisë për ndihmën e
14 tyre.

15 Z. Kehoe.

16 Z. KEHOE: [Përkthim] Shkurtimisht. Besoj se ka pasur një
17 ndryshim në renditjen e dëshmitarëve. A mund të kemi një
18 sqarim nga ZPS-ja lidhur me këtë, më duket se kanë ndryshuar
19 dëshmitarin, do jetë dëshmitari i tretë i pari, e kam kuptuar
20 siç duhet?

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] I drejtohem
22 Prokurorisë. A ka ndonjë ndryshim?

23 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Kemi dërguar një email
24 Mbrojtjes para disa ditësh edhe shërbimeve të Gjykatës. Ju
25 kemi vendosur në dijeni.

1 Nuk është ndryshim përfundimtar. Por nëse pyetjet dhe
2 kundërpjetet do jenë brenda afatit që kemi përcaktuar, do të
3 kemi një dëshmitar dhe pastaj do të kemi dy javë shkëputje nga
4 dëshmia e tyre dhe mbase do të ishte mbase arsyeja që ta
5 afronim një nga dëshmitarët në fillim të majit dhe jo ta
6 kishim në fillim të prillit.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A i keni
8 sqaruar këto në email?

9 Z. KEHOE: [Përkthim] Dëshmitari i tretë është një
10 dëshmitar goxha i rëndësishëm dhe ka shumë informacion edhe
11 kërkon shumë punë.

12 Edhe unë po ju kërkoja duke e pasur parasysh afatet që
13 kemi, domethënë, a po afrojmë dëshmitarin e tretë por nëse do
14 ta bëjmë? OK. Por, ju lutem, i nderuar Gjykatës, do i lutesha
15 Prokurorisë të na e konfirmojë këtë gjë.

16 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Besoj se kemi një problem më
17 themelor këtu, në këtë fazë, nuk e kemi parashikimin sa kohë
18 duhet për kundërpjetet. Menduam se do ta kishim. Edhe ju
19 Kryegjykatës e bëtë të qartë në vendimin tuaj, 01336.
20 Sidoqoftë, Mbrojtja e Selimit, më 20 mars, në faqen 2055 të
21 transkriptit thanë që kanë paradorëzuar pesë parashikime
22 kohore deri tani dhe janë duke rishikuar parashikimet e tjera
23 kohore.

24 E kemi marrë punën nga bishti. Na duhet të dimë sa kohë
25 duhet për kundërpjetet dhe pastaj ne të programojmë rendin e

1 dëshmitarëve. Nuk mund të konfirmojmë tani sesi do funksionojë
2 sepse duam të shohim sesa kohë do përdorim faktikisht. Por në
3 këtë fazë, sipas përllogaritjes që na është dhënë, mund të
4 themi që do kemi një shkëputje dy javore për marrjen në pyetje
5 të këtij dëshmitari konkret dhe ne duam që ta shmangim këtë
6 shkëputje kohore.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kur do ta
8 dini me siguri?

9 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Kjo do të varet nga koha që
10 do të përdorim ne për dëshmitarin e parë dhe të tretë. Prandaj
11 dhe e kemi njoftuar paraprakisht që mund të jetë e nevojshme
12 që ta shtyjme, më falni, dëshmitarin e tretë në varësi të
13 kohës që do të përdorim konkretisht.

14 Por, ne kemi pasur urdhër të qartë, për të pasur të qartë
15 sa kohë duhet për kundërpjetet më 13 shkurt dhe më 20 mars
16 pamë që ende s'i kishim këtë përllogaritje kohore. Prandaj do
17 të ishte më efikas ky proces sikur Mbrojtja të na e jepte
18 përllogaritjen e vetë kohore.

19 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk mund ta bëjmë ne këtë. Sepse
20 nëse duam të jemi efikas, teksa fillon ky gjykim dhe ta
21 kuptojmë si do të ecim, ZPS-ja do të vendosë dhe s'e ka të
22 qartë a do ta bëjmë tani dëshmitarin tre apo do ta shtyjme për
23 në maj.

24 Dhe unë po i drejtohem Gjykatësit dhe po ju them
25 Dëshmitari 3 kërkon goxha punë. Atëherë në qoftë se e shtyjme

1 Dëshmitarin 3, atëherë afrojmë Dëshmitarin 4 dhe 5. Por nuk
2 mund të funksionojmë në ajër, të shohim si do shkojnë gjërat,
3 a funksionojnë a s'funksionojnë, nuk na ndihmon ne kjo të
4 planifikojmë në mënyrën e përshtatshme.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Qëndroni ku
6 jeni. Do të shkëputemi pesë minuta. Ju lutem, nuk kam nevojë
7 për informacion shtesë. Qëndroni dhe do ju japim një urdhër me
8 gojë lidhur me këtë.

9 --- Pauza fillon në orën 10.11

10 --- Seanca rifillon në orën 10.19

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Morëm
12 parasysh kërkesën dhe përgjigjen e palëve dhe vendimi i Trupit
13 Gjykes është që nuk do të ketë ndryshim në renditjen e
14 dëshmitarëve sikurse është paraqitur më përpara. Ne do t'i
15 shqyrtojmë kërkesat për ndryshim kur lind një nevojë.

16 Numër dy. Të gjitha ekipet e Mbrojtjes duhet të dorëzojnë
17 jo më vonë se ditës së sotme një përllogaritje të plotë për
18 kundra pyetjet për 12 dëshmitarët e parë.

19 Tre. Përditësime nga ZPS-ja për të gjithë - palët,
20 pjesëmarrësit dhe Trupit Gjykes - pra, ZPS-ja duhet të na
21 japë këtë përllogaritje jo më vonë se përfundimit të dëshmisë
22 së dëshmitarit të parë më së shumti.

23 Me këtë mbylлим dhe seancën. Faleminderit.

24 --- Seanca mbyllet në orën 10.20

25